



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-111

PËR BLETARI

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1 (j) dhe 9.1 26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 dt. 15 maj 2001),

Miraton:

LIGJIN PËR BLETARI

Kapitulli I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë ligj rregullohet mbarështimi i bletëve, masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve të bletëve, mbikëqyrjen e objekteve të prodhimit dhe ruajtjes së prodhimeve të bletëve.

Neni 2
Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto domethënie:

“**Bletari**”- nënkupton mbarësh-timin, rritjen, shumëzimin, prodhimin dhe qarkullimin e bletëve të species *Apis Mellifera*, prodhimeve të bletëve si dhe pajisjet për bletari;

“**Bletë**” - nënkupton amat, bletët punëtore dhe brumbujt;

“**Bletë grabitëse**”- bletë e cila e sulmon bletën tjetër për t’ia grabitur ushqimin;

“**Shoqëri bletësh**”- nënkupton bashkësinë e amave, bletëve punëtore dhe brumbujve të vendosura në zgjua;

“Bletore” – vendi ku vendosen zgjojet me bletë, mund të jenë të hapura ose në ndonjë shtëpizë me etazhe, por mund të vendoset edhe në makina për transport;

“Prodhimet e bletëve janë” – mjalti, dylli, propolisi, luzma e bletës dhe helmi i bletës (apitoksina);

“Bletar” - person fizik ose juridik i cili mërret me bletari për përfitimin e prodhimeve të bletëve dhe amave të bletëve;

“Mjalti natyral”- nënkupton mjaltin dhe prodhimet e mjaltit pa përdorimin e shtojcave dhe pa trajtim me mjete kimike;

“Mjalti organik” - mjaltë i prodhuar nën mbikëqyrje të përhershme, i analizuar para se të vihet në qarkullim. Në mjaltë organik ndalohej trajtimi me barna për të eliminuar gjetjen e mbetjeve (reziduve);

“Ministria” - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR);

“AVUK”- Agjencioni Veterinar dhe i Ushqimit i Kosovës;

“LBK” - Lidhja e Bletarëve të Kosovës;

”L.R” - Lankstrot Root;

”D.B” – Dadant Blat.

Neni 3

Rëndësia e sektorit të bletarisë

3.1 Bletaria është sektor i rëndësishëm i bujqësisë së vendit, burim prodhimesh natyrale me vlerë të lartë ushqimore, dietike e mjekësore.

3.2. Bletët përmes Pjalmimit ose polenizimit ndikojnë në rritjen e prodhimit të shumë kulturave bujqësore.

3.3. Bletët ndikojnë në mbajtjen e florës së pyjeve dhe kullosave duke ripërtërirë natyrën si hallkë të zinxhirit ekologjik.

3.4. Ushtrimi i veprimtarisë së bletarisë realizohet në bletore nga bletaret të cilët janë persona fizik ose juridik dhe të cilët posedojnë shoqëri bletësh dhe pajisje të nevojshme për zhvillimin e kësaj veprimtarie sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 4

Regjistri i bletarëve

4.1 Personi fizik apo juridik që merret me bletari është i obliguar të lajmërojë në Drejtorinë Komunale për Bujqësi, deri më 30 prill të çdo viti kalendarik, për numrin dhe vendin e vendosjes së shoqërive të bletëve, për të hyrë në regjistrin e bletarëve.

4.2 Drejtorit Komunal të Bujqësisë obligohen të sjellin regjistrin e bletarëve në MBPZHR në afat prej 30 ditësh pas përfundimit të afatit të regjistrimit.

Kapitulli i II
Neni 5
Vendosja e bletores

5.1 Bletorja mund të jetë e stacionuar apo lëvizëse.

5.2 Bletari është i obliguar të vendos bletoren në atë mënyrë që të mos pengoi fqinjët, kafshët dhe komunikacionin publik.

5.3 Ndalohet vendosja e bletores në afërsi të auto rrugëve, hekurudhave dhe aeroporteve.

5.4 Ndalohet vendosja e bletores në afërsi të fabrikave për prodhimin e sheqerit, lëngjeve, verërave, stallave dhe plehrishteve.

5.5 Ndërmarrjet prodhuese që merren me prodhimin dhe përpunimin e pemëve dhe rrushit si dhe njësit e ngjashme tek të cilat përdorët ambalazhi që është i dëmshëm për bletë, obligohen të mbajnë në vend të mbyllur ambalazhin e përdorur.

5.6 Prodhuesit e lëngjeve, ose ëmbëlsirave të tjera janë të obliguar që me anë të rrjetave mbrojtëse të mbrojnë objektet e prodhimit ose depot e këtyre prodhimeve nga bletët, që të mos vije deri te dëmtimi masovik i shoqërive të bletëve në këto objekte.

5.7 Kushtet nga paragrafi 5 i këtij neni nuk do të zbatohen në vendet ku nuk ka lulëzim të bimëve edhe gjatë sezonit të dimrit.

Kapitulli i III
Neni 6
Lëvizja dhe transporti i bletëve në kullota

Shfrytëzimi i kullotave nga bletët është i lirë dhe pa kompensim.

Neni 7

7.1 Çdo subjekt që ushtron veprimtarin e bletarit i cili lëviz brenda ose jashtë Komunës me bletore duhet të bëjë kërkesë me shkrim në Zyrën e Drejtorisë Komunale për Bujqësi së paku 20 ditë para datës së lëvizjes.

7.2 Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet edhe certifikata veterinare për gjendjen shëndetësore të bletëve dhe raporti për masat e ndërmarra veterinare.

Neni 8

Drejtoria Komunale për Bujqësisë pasi të merr mendimin e ekspertit në bashkëpunim me Shoqatën e Bletarëve miraton apo refuzon vendosjen e bletores.

Neni 9

Çdo subjekt pas miratimit të kërkesës për lëvizjen e bletëve në vendin e caktuar, duhet të ruaj distancën nga bletoret tjera së paku 50 metra dhe të respektoj të gjitha detyrat e përcaktuara nga inspektori i veterinars për masat profilaktike dhe kurative që aplikohen në atë kohë në atë zonë.

Neni 10

10.1 Bletarët e shteteve tjera mund t'i shfrytëzojnë kullotat e Kosovës vetëm pas marrjes së lejes nga MBPZHR.

10.2 Kërkesës për leje të bletarit duhet bashkangjitur këtë dokumentacion:

- a) numri i shoqërive të bletëve;
- b) pëlqimin e pronarit të tokës ose Komunës ku do të vendoset bletorja;
- c) Certifikatën e gjendjes shëndetësore të bletëve nga shërbimi veteriner i vendit nga vinë bletët;
- d) Pëlqimin e Lidhjes së Bletarëve të Kosovës për shfrytëzimin e lokacionit të përzgjedhur.

10.3 Leja duhet të përmbaj vendin, Komunën, kohën e arritjes së bletëve dhe kohëzgjatjen e shfrytëzimit të kullotave në Kosovë.

10.4 Gjatë lëvizjes së bletëve, bletari duhet të posedoi certifikatën e gjendjes shëndetësore dhe certifikatën e transportit nga Agjencioni Veteriner dhe i Ushqimit i Kosovës.

Neni 11

Me rastin e vendosjes së bletores në kullosa, bletarët duhet ta vejnë tabelën në vend të dukshëm, ku tregohet numri i shoqërive, identiteti dhe adresa e pronarit si dhe numri i bletores sipas regjistrimit të organit kompetent.

Neni 12

Tri ditë para vendosjes së bletëve në kullotë, bletari është i obliguar të njoftojë inspektorin veterinar ose të blegtorisë për vendin e vendosjes së bletores.

Neni 13

Transportimi i bletëve në bletore mund të bëhet me të gjitha mjetet e transportit me kusht që të jenë të mbyllura për të penguar fluturimin e bletëve gjatë transportit.

Neni 14

14.1 Përveç pronarit që transporton bletët edhe përcjellësi i transportit të bletëve duhet të ketë njohuri për bletari.

14.2 Transporti i bletoreve transit nëpër territorin e Kosovës rregullohet me akt nënligjor nga Ministria.

Neni 15

Me qellim të pengimit të paraqitjes së grabitjes së bletëve nga bletët "grabitëse" bletari është i obliguar të ndërmerr të gjitha masat paraprake për evitimin e kësaj dukurie në bletoren e vet.

Neni 16

16.1 Për mjetet e specializuara për bletore lëvizëse Bletari obligohet të kërkojë leje për lëvizje të tyre nga Shërbimi Policor i Kosovës.

16.2 Mjeti lëvizës nuk obligohet të ketë regjistrim të përhershëm.

Kapitulli i IV

Neni 17

Riprodhimi i Bletëve

Për përzgjedhje të bletëve duhet të përdoret lloji i bletës Evropiane *Apis Mellifera* dhe nënlojet lokale të bletëve.

Neni 18

Për përzgjedhjen e llojit të bletëve, bletari duhet të ketë në konsiderim përshtatjen e llojit kushteve lokale dhe rezistencës ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve.

Neni 19

19.1 Familjet e bletëve krijohen me shumëzimin e familjeve ekzistuese të bletëve.

19.2 Luzmat e bletëve dhe amat e bletëve prodhohen në bletoret e specializuara për riprodhim të certifikuara nga MBPZHR.

19.3 Certifikimi i bletoreve për prodhimin e luzmave të bletëve dhe amave rregullohet me Udhëzim Administrativ nga Ministria.

Kapitulli i V

Neni 20

Mbrojtja e bletëve

Bletari është i obliguar që në bletoren e vet të ndërmerr të gjitha masat për parandalimin, luftimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjeve duke përdorur preparatet e regjistruara dhe të aprovuara nga Agjencioni Veterinar dhe i Ushqimit i Kosovës.

Neni 21

21.1 Bletarët, Shoqatat e Bletarëve dhe Lidhja e Bletarëve të Kosovës që veprojnë në territorin e Kosovës obligohen të ndërmarrin të gjitha masat preventive për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve të bletëve, sipas dispozitave të Ligjit për veterinarinë dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të këtij ligji.

21.2 Masat nga paragrafi 1 i këtij neni ndërmirën nën mbikëqyrjen e inspektorit veterinar të AVUK-së.

Neni 22

22.1 Çdo bletarë me rastin e dyshimit të paraqitjes së sëmundjeve me karakter përhapës siç janë: Nosemoza-Nosemosis, Varooza -Varosis, Acarapis -acarosis, Pesta Amerikane-Pestis Apium dhe Pesta Evropiane-Pestis Apis si dhe dëmtimeve të paignifikuar ose helmimet, obligohet të lajmëroi menjëherë inspektorin veteriner për diagnostifikimin e sëmundjes.

22.2 Inspektori duhet t'i ndërmerë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e përhapjes së sëmundjes në pajtim me Ligjin për veterinarinë.

Neni 23

Masat profilaktike dhe luftimi i sëmundjeve të bletëve përcaktohet në fillim të çdo viti kalendarik për vitin vijues nga Agjencioni Veterinar dhe i Ushqimit i Kosovës, në bashkëpunim me ekspertet e Lidhjes së Bletarëve të Kosovës;

Neni 24

24.1 Ndalohet asgjësimi i shoqërive të bletëve përveç në rastet e vërtetimit në mënyrë laboratorike nga instituti përkatës i prezencës së sëmundjes ngjitëse të rrezikshme, Pesta Amerikane.

24.2 Asgjësimi behët në prezencë të inspektorëve të veterinars dhe blegtorisë dhe të përfaqësuesve të Lidhjes së Bletarëve të Kosovës.

24.3 Kompensimi i dëmeve për asgjësimin e bletëve rregullohet me dispozitat e Ligjit për veterinarinë.

Neni 25

Qarkullimi dhe përdorimi i preparateve për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve të bletëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin për produktet medicinale dhe pajisjet medicinale, duke konsultuar ekspertet e Lidhjes së Bletarëve dhe Institutin përkatës.

Neni 26

Ndalohet trajtimi me preparate të cilat nuk e kanë lejen për përdorim sipas Ligjit për veterinarinë dhe Ligjit për produktet medicinale dhe pajisjet medicinale.

Neni 27

Gjatë lëvizjes së bletëve, bletari duhet të posedoi certifikatën e gjendjes shëndetësore dhe certifikatën e transportit nga Agjencioni Veterinar dhe i Ushqimit i Kosovës.

Neni 28

Ndalohet përdorimi i preparateve helmuese dhe materieve tjera të cilat përmes produkteve të bletës mund ta dëmtojnë shëndetin e njeriut.

Neni 29

29.1 Ndalohet spërkatja e bimëve në lokalitetet ku janë të vendosura bletët në kohën e lulëzimit.

29.2 Në raste të domosdoshme të spërkatjes së bimëve, bletaret dhe shoqatat e bletarëve duhet të lajmërohen 10 ditë përpara, përmes mediave dhe shpalljeve, për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e bletëve.

Neni 30

30.1 Pasi të publikohet lajmërimi mbi vendin dhe kohën e spërkatjes së bimëve me preparate kimike (pesticide) helmuese për bletën, bletari është i obliguar të ndërmerr të gjitha masat mbrojtëse duke i mbyllur dyert e zgjojeve ose duke larguar shoqëritë e bletëve së paku 6 km larg në vijë ajrore nga zona e spërkatjes për një kohë të caktuar.

30.2 Nëse bletari nuk i ndërmerr masat adekuate sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk ka të drejt të kërkojë dëmshpërblim nga askush për helmimin e bletëve.

Kapitulli i VI

Neni 31

Kërkesat sanitare të prodhimeve dhe repromaterialit për bletë

Produktet e bletës mund të tregtohen vetëm pas plotësimit të kërkesave higjienike dhe sanitare.

Neni 32

Mjalti që tregtohet për ushqim duhet:

- a) Të jetë i pastër nga çdo shije dhe aromë e huaj, vetëm me aromë të bimës nga e cila është sjell nektari;
- b) Të mos ketë lagështi mbi 18 %;
- c) Të mos përmbaj saharozë mbi 5%;
- d) Përmbajtja e fruktozës dhe glukozës të jetë së paku 65%;
- e) Të mos ketë filluar procesi i fermentimit;
- f) Të mos ketë kaluar proceset termike mbi 45 °C ;
- g) Të mos jetë i ngjyrosur me ngjyresës sintetik;
- h) Të mos ketë konzervans dhe aromatizues.

Neni 33

Përbërja kimike e mjaltit dhe produkteve të tjera të bletës duhet të përmbushin kërkesat mbi cilësinë e mjaltit dhe prodhimeve të mjaltit.

Neni 34

Mjalti i destinuar për pastiqeri dhe industri por që konsumohet nga njerëzit , duhet të plotësojë të gjitha standardet e mjaltit për konsum, përveç numrit diastolik dhe përqindjes së hidrometilfulfurolit (HMF).

Kapitulli i VII

Neni 35

Kushtet për vënien në qarkullim të Shoqërive të bletëve, amave dhe prodhimeve të bletëve

Personi fizik apo juridik që merret me bletari mund t'i vejë në qarkullim:

- a) shoqëritë e bletëve dhe amat nëse janë të shëndosha dhe nuk rrjedhin nga shoqëritë e bletëve të infektuara nga sëmundjet siç është Pesta Amerikane dhe Evropiane, Akaroza dhe Nozematoza;
- b) mjalti dhe prodhimet e mjaltit që plotësojnë kërkesat sanitare dhe që nuk përmbajnë materie të dëmshme për shëndetin e njerëzve;
- c) zgjojet e bletëve të tipit Lankstrot Root dhe Dadant Blat;
- d) fletët e dyllit të tipit standard të prodhuara nga dylli i pastër 100% dhe të mos përmbaj materie tjera ose parafin;
- e) pogaçja prej dyllit të ketë deklaron me përmbajtje kimike.

Neni 36

Kushtet minimale për cilësinë e mjaltit dhe prodhimeve të mjaltit të cilat vihen në qarkullim, prodhimet me bazë mjalti, kushtet minimale për përcaktimin dhe ruajtjen e cilësisë, metodat për kontrollin e cilësisë, metodat e marrjes së mostrave si dhe metodat e analizave fizike dhe kimike të prodhimeve, përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.

Neni 37

Të gjitha prodhimet e bletëve të cilat vihen në qarkullim, në paketim, në mbështjellës, në enë me etiketë, duhet të kenë deklaronin i cili përmban këto të dhëna:

- a) emërtimi i prodhimit apo emri i tij tregtar;
- b) emri dhe selia e prodhuesit;
- c) Data e prodhimit (paketimit) dhe data e skadimit;
- d) neto sasia e prodhimit;
- e) për mjaltë, prejardhja nga bima dhe metodat e përpunimit;
- f) nëse mjalti dhe prodhimet e mjaltit përzihen me prodhime tjera duhet të deklarohet raporti i pjesëmarrjes në %;
- g) të dhëna tjera me interes për konsumatorin.

Neni 38

Deklaracioni për mjaltin dhe prodhimet e mjaltit nga importi përveç të dhënave nga neni 37 i këtij ligji duhet të ketë edhe të dhënat se është prodhim nga importi, të jetë në gjuhën zyrtare që përdoret në Kosovë dhe emrin e shtetit ku është prodhuar.

Kapitulli i VIII

Neni 39

Objektet për përpunimin dhe ruajtjen e mjaltit dhe prodhimeve të mjaltit

39.1 Personi fizik apo juridik i cili bën përpunimin dhe ruajtjen e mjaltit duhet t'i ketë këto objekte:

- a) për pranimin, vjeljen e mjaltit dhe mirëmbajtjen e ambalazhit;
- b) për përpunimin, mbushjen dhe paketimin e mjaltit;
- c) për deponimin e prodhimeve të paketuara;
- d) për gardërobë dhe nyja sanitare.

39.2 Numri, madhësia dhe pajisja e objekteve nga paragrafi 1 i këtij neni duhet t'i plotësoi këto standarde:

- a) muret dhe dyshemeja të jenë të ndërtuara nga materiali rezistues nga lagështia me ngjyrë të hapur të rrafshëta për mirëmbajtje të lehtë;
- b) dyert dhe dritaret të pamundësojnë hyrjen e insekteve dhe brejtësve;
- c) dritë difuzive të njëtrajtshme me intensitet të caktuar;
- d) pajisje të përshtatshme për teknologjinë e prodhimit të ndërtuara nga materiali i cili nuk ndikon në ndryshimin e cilësisë së mjaltit;
- e) të ketë pajisje për ujë të ngrohtë dhe të ftohtë për mirëmbajtjen e objektit dhe pajisjeve;
- f) të ofroi mundësi për largimin e ujërave të zeza nga dyshemeja dhe pajisjet për kanalizim ose gropë septike.

39.3 Objektet për përpunimin dhe ruajtjen e mjaltit dhe prodhimeve të mjaltit duhet të licencohen në MBPZHR.

39.4 Procedurat për licencimin e objekteve për përpunimin dhe ruajtjen e mjaltit dhe prodhimeve të mjaltit përcaktohen me akt nënligjor nga MBPZHR.

Neni 40

Transporti i hojve me mjaltë nga bletorja deri të vendi i vjeljes duhet të bëhet në atë mënyrë që të pengohet kontaminimi i mjaltit dhe qasja e bletëve.

Neni 41

Mjalti dhe prodhimet e mjaltit duhet të ruhen në vende të thata në temperaturë më të ulët se 25°C dhe lagështi relative të ajrit deri në 80%.

Neni 42

Ndalohet vjelja e mjaltit nga kornizat ku ka çerdhe të bletëve.

Kapitulli i IX

Neni 43

Mbikëqyrja

Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala nga ky ligj e bëjnë inspektorët e blegtorisë dhe veterinerës.

Neni 44

Inspektori i blegtorisë përveç autorizimeve që i ka sipas dispozitave ligjore është i autorizuar:

- a) Të bëjë kontrollimin e bletoreve, shoqërive të bletëve, pajisjeve dhe veglave të bletarit si dhe produktet e bletës në prodhim dhe qarkullim;
- b) Të bëjë kontrollin e vendosjes së bletëve në bletore të përhershme ose lëvizëse, si dhe të urdhëroi dislokimin e tyre nëse janë të vendosura në kundërshtim me ligj;
- c) Të bëjë kontrollin e përdorjes së pesticideve të cilat janë helmuese për bletën në fazën e lulëzimit të bimëve;
- d) Të ndaloj përdorimin e pesticideve të dëmshme për bletën pa lejen e organeve të autorizuar dhe pa lajmërimin në media për përdorimin e pesticideve.

Kapitulli i X

Neni 45

Dispozitat ndëshkuese

45.1 Dënohet me gjobë për kundërvajtje personi fizik apo juridik në shumë prej 200 € deri 2.000 € nëse:

- a) nuk e lajmëron numrin e shoqërive të bletarëve sipas nenit 4, të këtij ligji;
- b) vendos bletoren në kundërshtim me nenin 5, të këtij ligji;
- c) lëviz bletët pa aprovimin e organit kompetent sipas nenit 7, të këtij ligji;
- d) shfrytëzon kullotat e Kosovës në kundërshtim me nenin 10 të këtij ligji;
- e) transporton bletët në kundërshtim me nenin 13 dhe 14, të këtij ligji;
- f) bletari nuk ndërmerr masa për evitimin e bletëve “grabitëse” sipas nenit 15, të këtij ligji;
- g) lëviz bletoren me automjete të specializuara pa lejen e organit kompetent sipas neni 16, të këtij ligji;
- h) nuk mbarështon specien e bletës *Apis Mellifera* sipas nenit 18, të këtij ligji;
- i) prodhon luzma dhe ama të bletëve në kundërshtim me nenin 19, paragrafi 2, të këtij ligji;
- j) nuk i ndërmerr masat preventive për luftimin e sëmundjeve të bletëve nën mbikëqyrjen e inspektorëve kompetent sipas nenit 21, të këtij ligji;
- k) nuk lajmëron inspektorët përkatës për dyshimin e paraqitjes së sëmundjeve me karakter përhapës sipas nenit 22, të këtij ligji;

- l) bën asgjësimin e bletëve në kundërshtim me nenin 24 të këtij ligji;
- m) nuk trajton bletët me preparate dhe medikamente sipas nenit 26, të këtij ligji;
- n) përdor preparate helmuese të cilat përmes produkteve të bletëve janë të dëmshme për shëndetin e njeriut sipas nenit 28, të këtij ligji;
- o) spërkat bimët pa paralajmërim sipas nenit 29, të këtij ligji;
- p) nëse i tregton prodhimet e bletëve në kundërshtim me nenin 31 dhe 32, të këtij ligji;
- q) ven në qarkullim shoqëritë e bletëve dhe amave në kundërshtim me nenin 35, të këtij ligji;
- r) nuk përmban deklaracion sipas nenit 37 dhe 38, të këtij ligji;
- s) nuk posedon objektet dhe pajisjet sipas nenit 39, të këtij ligji.

45.2 Dënohet me gjobë për kundërvajtje personi fizik apo juridik në shumë prej 100 € deri 500 € nëse:

- a) ushtron veprimtarin e bletarisë në kundërshtim me neni 3, paragrafi 4, të këtij ligji;
- b) nuk respekton distancën e vendosjes së bletores sipas nenit 9, të këtij ligji;
- c) nuk vendos tabelën dhe nuk informon inspektorin përkatës sipas nenit 11 dhe 12 të këtij ligji;
- d) nuk posedon certifikatën e gjendjes shëndetësore të bletëve me rastin e lëvizjes së tyre sipas nenit 27, të këtij ligji;
- e) nuk ruhen prodhimet e bletës sipas nenit 41, dhe 42, të këtij ligji.

Neni 46

Mjetet e realizuara nga shqiptimi i dënimeve sipas dispozitave të këtij ligji derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës

Kapitulli i XI

Neni 47

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohet Ligji për bletarinë Gazeta Zyrtare KSAK Nr. 13, faqe 526 e datës 28 prill 1974 dhe çdo dispozitë që është në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 48

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-111
30 mars 2007

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Kolë Berisha